



# Plani i Punës së Kolegjiut për Administratë dhe Personel për 2011

## I. Strategjia e AKK-së për periudhën 2011-2015

Vizioni dhe misioni i AKK-së i përcaktuar në Strategjinë për periudhën 2011-2015 (të aprovuar nga Bordi i AKK-së) sheh AKK-në në vitin 2015 si organizatë më të fuqishme dhe më efektive në:

1. Avokim në emër të komunave tek niveli qendror, dhe
2. Shërbim të nevojave të komunave anëtare

Me realizim të këtij vizioni dhe misioni do të dëshmohet dobishmëria dhe këmbëngulësia e AKK-së, dhe pritet që komunat do të paguajnë anëtarësinë në tërësi dhe kështu të sigurojnë qëndrueshmërinë financiare të AKK-së.

Rezultatet e pritura nga katër fushat strategjike të veprimit për realizim të vizionit dhe misionit janë:

### 1. Avokim dhe lobim pro-aktiv

- Interesat e komunave janë promovuar dhe mbrojtur tek qeveria qendrore, agjensionet ndërkombëtare dhe institucionet tjera relevante
- Aktivitetet lobuese janë koordinuar në mënyrë efektive për t'i mundësuar komunave të flasin njëzëri
- Legjislacioni që afekton kompetencat komunale është harmonizuar dhe shërben interesat e komunave

### 2. Zhvillim efektiv i kapaciteteve

- Koncepti afatgjatë dhe i bazuar në nevoja për zhvillim të kapaciteteve dhe trajnime për komuna është zhvilluar gradualisht dhe është duke u zbatuar
- Trajnim kualitativ i ofruar bazuar në kërkesa specifike të komunave

### 3. Përmirësim në ofrim të shërbimeve

- Funkcionim efektiv i brendshëm i administratave komunale është përkrahur përmes harmonizimit të strategjive, akteve, organizimit si dhe procedurave relevante komunale të cilat shërbejnë qytetarët dhe sektorin privat
- Ofrim i ekspertizës së kualifikuar teknike dhe ligjore në fushat ku komunat dhe Kolegjiut nuk kanë ekspertizë të tillë
- Ofrim i shërbimeve specifike komunave të reja që nxisin integrimin
- Ofrim i këshillave të kualifikuara dhe lobim efektiv për financim nga palët e treta

### 4. Efiçenca organizative

- Në vitin 2015, AKK është një organizatë kompetente, e përparuar dhe financiarisht e qëndrueshme, me leverdi substanciale në procesin e decentralizimit
- Bordi dhe Këshilli i Kryetarëve ofrojnë udhëzime strategjike
- AKK, kryesisht përmes "Miqëve të AKK-së", mirëmban marrëdhënie të shkëlqyera me komunitetin e donatorëve ndërkombëtarë

## **II. Prioritetet e Kolegjiumit për Administratë dhe Personel në vitin e kaluar (2010)**

1. Mungesa e përshkrimeve përkatëse të punës;
2. Komunat me kompetenca të ndryshme për pozitën e drejtorit;
3. Dallimi në paga për këtë pozitë;
4. Si të përfshihet MAPL-ja në aktivitetet e Kolegjiumit;
5. Koordinimi më i mirë në trajnimin e stafit;
6. Reformimi i administratës publike;
7. Si duhet të funksionoj procesi i shqyrtimit administrativ?
8. Qartësimi i procesit të emërimeve;
9. Përpilimi i model statutit komunal;
10. Identifikimi i papajtueshmërive në kornizën ligjore;
11. Cilat janë konfliktet e vërteta të interesit;
12. -Mos-mbajtja e përgjegjësive për shkeljet ligjore;
13. Nevoja për një model organogram;
14. Marrja me ankesa në komuna
15. Unifikimi i numrit të protokollit për shkresat komunale;
16. Ndarja e obligimeve mes noterëve dhe komunës;
17. Themelimin e Kolegjiumit të veçantë për Udhëheqësit e Personelit
18. Të ketë aplikim strikt të rregulloreve për numrin e stafit komunal

## **III. Projektligjet për vitin 2011 në Strategjinë Legjislative Qeveritare**

- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-241 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës 31 maj 2011 ;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik 31 maj 2011;
- Projektligji për punën në zyrë 31 gusht 2011;
- Projektligji për qeverisje elektronike 30 tetor 2011;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-28 për procedurën administrative 30 tetor 2011;
- Projektligji për pagat e funksionarëve publikë 30 prill 2011;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-001 për përfitimin e ish zyrtarëve të lartë 30 prill 2011 ;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës 1 maj 2011;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/2 për barazi gjinore 1 gusht 2011;
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë 1 nëntor 2011
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/7 për lëndën Arkivore dhe Arkivat 30 gusht 2011 ;

## **IV. Plani Vjetor i Punës për vitin 2011**

Plani Vjetor i Kolegjiumit për vitin 2011 ka për qëllim të:

- organizoj punën e Kolegjiut
- bashkërendoj idetë dhe lehtësoj/udhëheq zbatimin e aktiviteteve
- arrijen e objektivave të Kolegjiut dhe AKK-së, dhe
- kontribuoj në përmirësimin e vetë-qeverisjes lokale në Kosovë

AKK ka organizuar takimin e Kryesisë së Kolegjiut me 14 prill 2011 dhe ka përgatitur Planin e Punës për vitin 2011 ku në vija të trasha janë përcaktuar:

1. 2 prioritete
2. Objektivat
3. Aktivitetet
4. Datat (muajt) për takimeve gjatë vitit 2011

Plani i Punës është në përputhje me i) fushat strategjike të veprimit në kuadër të Strategjisë së AKK-së 2011-2015, ii) prioriteteve të identifikuar për vitin e kaluar 2010, iii) Strategjinë Legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2011, dhe v) çështjet e ngritura gjatë vizitave të AKK-së në të gjitha Komuna te Kosovës.

Ky Plan i Punës duhet të shihet si një dokument i cili ka nevojë për azhurnim dhe plotësim të vazhdueshëm në mënyrë që t'i përshtatet kërkesave dhe nevojave të komunave të Kosovës sipas situatës në teren.

**Plani Vjetor i Punës për vitin 2011 për Kolegjin për Administratë**

		Takimi 1 10 maj 2011	Takimi 2 10 qershor	Takimi 3 shtator	Takimi 4 tetor	Takimi 5 dhjetor
<b>Prioriteti I</b>	<b>Infrastruktura ligjore relevante për Drejtoritë e Administratës</b>					
<b>Objektiva I.1</b>	<b>Zbatimi i ligjit për shërbimin civil dhe ligjit për pagat</b>					
Aktiviteti I.1.1	Unifikimi i organogrameve dhe koeficienteve (të pritët kompletimi i akteve nënligjore)		X (të definohet)			
Aktiviteti I.1.2	Unifikimi i përshkrimeve të vendeve të punës (në katër kategori)		X (të definohet)			
Aktiviteti I.1.2	Kompletimi i akteve nënligjore				Në bashkëpunim me MAP dhe MAPL	
Aktiviteti I.1.2	Trajnim për Drejtorët dhe stafin e Administratës në përpilim të vendimeve komunale		Në bashkëpunim me IKAP/MAPL			
<b>Objektiva 2</b>	<b>Koordinimi më i mirë me ministrinë e linjës</b>					
Aktiviteti I.2.1	Pjesëmarrje në Grupet Punuese në procesin legjislativ (sipas Strategjisë Legjislative 2011)	Identifikimi i pjesëmarrësve potencial në GP				
Aktiviteti I.2.2	Harmonizimi mes ligjit për noterinë dhe kompetencave komunale			X (të definohet)		
<b>Prioriteti II</b>	<b>Përmirësim i shërbimeve të Drejtorive të Administratës</b>					
<b>Objektiva II.1</b>	<b>Ofrimi i shërbimeve më të mira për qytetarët</b>					
Aktiviteti II.1.1	Zyra pritëse/Qendra për shërbime ndaj qytetarëve (Gjilani, Skenderaji, Mitrovica, Shtime dhe Peja përfitojnë nga DEMI)	Shkëmbimi i përvojave (prezantim nga Gjilani dhe Peja, si dhe vizitë në Gjilan)				
Aktiviteti II.1.2	Vlefshmëria e dokumenteve të ofiqarisë	Ndikim tek institucionet për të mos kërkuar ripërtëritjen e dokumenteve				
Aktiviteti II.1.3	Unifikimi i numrit të protokoleve			X (të definohet)		

Raportimi për vitin 2011 dhe planifikimi për 2012

